

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “TEPEGOLD” SH.P.K.

Neni 1

Formimi

Sot me datë 12.06.2023 mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, Kodin Civil dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “TEPEGOLD” SH.P.K.

Kjo shoqëri krijohet nga:

1. **Nurettin Tepe**, i datëlindjes 10.12.1972, lindur në Horasan-Turqi dhe banues në Tiranë,
2. **Kutlu Kusay**, i datëlindjes 19.04.1977, lindur në İzmit-Turqi dhe banues në Tiranë

Neni 2

Selia

Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “TEPEGOLD” SH.P.K. është në adresën: **Rruga Astrit Losha, Pallati Marituda, Zona Kadastrale 3866, Pasuria Nr. 300/142, Kati i pare, Dyqani Nr. 15, Kashar, Tiranë.**

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “TEPEGOLD” SH.P.K. është e pacaktuar.

Neni 4

Objekti Veprimtarisë

1. Të importojë dhe eksportojë filtra dhe sisteme trajtimi uji
2. Të tregtojë me shumicë dhe pakicë filtra dhe sisteme trajtimi uji
3. Tregtimi me shumicë i të gjithë llojeve të materialeve të ndërtimit
4. Tregtimi me pakicë i të gjithë llojeve të materialeve të ndërtimit
5. Importimi dhe eksportimi i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit

6. Të kryejë punime dhe shërbime ndërtimi të çdo lloji
7. Të ndërtojë ndërtesa banimi, ura, vepra arti dhe çdo lloj pune që lidhet me ndërtimin
8. Të bëjë montimin e ndërtesave parafabrikate
9. Të ndërtojë Hotele dhe Resorte Turistike
10. Të hapë dhe menaxhojë Hotele, Resorte Turistike, Bar Kafë etj
11. Të hapë dhe menaxhojë agjensi turistike
12. Të operojë në fushën e turizmit
13. Të importojë, eksportojë dhe tregtojë me shumicë dhe pakicë të gjitha llojet e pajisjeve elektrike dhe materialeve elektrike.
14. Të importojë, eksportojë dhe të shesë me shumicë dhe pakicë detergjente dhe produkte kozmetike.
15. Të importojë, eksportojë dhe të shesë me shumicë dhe pakicë të gjitha llojet e produkteve për dhurata dhe lodrave për fëmijë.
16. Të importojë, eksportojë, prodhojë dhe tregtojë me shumicë dhe pakicë mobilje
17. Të importojë, eksportojë dhe të tregtojë me shumicë dhe pakicë enë kuzhine të të gjitha llojeve.
18. Të importojë, eksportojë dhe tregtojë me shumicë dhe pakicë të gjithë llojet e tekstileve, veshje, veshmbathje, copa etj.
19. Të importojë, eksportojë dhe tregtojë me shumicë dhe pakicë të gjitha llojet e pajisjeve elektronike.
20. Të importojë, eksportojë dhe tregtojë me shumicë të gjitha llojet e kimikateve dhe të bëjë transportine tyre me mjetet e veta ose me të tretë për përmbushjen e këtij qëllimi.
21. Të transportojë mallrat e tregtuara nga ana e saj me mjetet e veta ose të kontraktuara për përmbushjen e aktivitetit të saj.
22. Të kryejë transport brenda dhe jashtë vendit të mallrave të veta dhe të të tretëve me mjetet e veta ose të kontraktuara nga të tretë për përmbushjen e këtij qëllimi.
23. Të shërbejë si distributor i shoqërive dhe markave të ndryshme vendi dhe të huaja. Të përfaqësojë shoqëri të huaja.
24. Të kryejë shitblerjen me shumicë dhe pakicë të të gjitha materialeve dhe shërbimeve të lejuara nga legjislacioni shqiptar.

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë


Kapitali themeltar i shoqërisë “TEPEGOLD” SH.P.K. është 200.000 (Dyqind mijë) Lekë, i ndarë në 2 kuota si vijon:

1. **Nurettin Tepe** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (Njëqind mijë) Lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. **Kutlu Kusay** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (Njëqind mijë) Lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6

Organet e Shoqërisë dhe Asambleja

Organet drejtuese të shoqërisë “TEPEGOLD” SH.P.K. janë:



- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim – marrës.
- Administratorë të shoqërisë, janë **Z.Kutlu Kusay dhe Z.Nurettin Tepe**. Shoqëria do të administrohet nga **Z.Kutlu Kusay dhe Z.Nurettin Tepe**, si administratorë të saj, të cilët përfaqësojnë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

Neni 7

Të drejtat e detyrat e asamblesë, organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë vendas apo të huaj, shprehen në statut, i cili bashkë me aktin e themelimit janë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e aktiviteteve të saj.

Neni 8

Veprimtarinë e saj, shoqëria do t'a zhvillojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Neni 9

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, me anë të dispozitave të ketij akti, statutit dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat atëherë zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


Ky Akt Themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“TEPEGOLD” SH.P.K.** në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë. Në këtë ditë shoqëria **“TEPEGOLD” SH.P.K.** njihet si person juridik.

Neni 10

1. Ky akt formulohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 1(një) kopje.
2. Ortakët e shoqërisë i japin të drejtën **Z.Armand Shkurta**, të paraqitet pranë QKB-së dhe çdo institucioni tjetër për regjistrimin e shoqërisë **“TEPEGOLD” SH.P.K.**

ORTAKET E SHOQERISE

Nurettin Tepe



Nurettin Tepe

Kutlu Kusay

